

VENDIM
Nr.549, datë 3.8.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.485, DATË 11.9.1995 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FUNKSIONET E PROGRAMIT “TEMPUS””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.485, datë 11.9.1995 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 4, të shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1.Drejtori i zyrës së programit “Tempus” emërohet nga Kryeministri, me pagë mujore të kategorisë II-b të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave. Fondet për pagën e drejtorit të zyrës së programit “Tempus” të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano